



GJAKOVA



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenin 2, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 03/l-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/l-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 05/l-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. **Miratohet** shpronësimi për interesin publik i pronës së paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, e cila ndodhet në zonën kadastrale: Gjakovë Jashtë Qytet, me nr. të Parcelës 4375-7, e cila përfshihet nga projekti “Ndërtimi i rrugës Kolë Lleshi” në Gjakovë, sipas tabelarit i cili është bashkangjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga departamenti për vlerësimin e pronës së paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe tabela në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilave janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, njoftohet subjekti kërkues dhe personat e tjerë të identifikuar në tabelën e përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar, Organi Shpronësues bën shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues respektivisht cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura te këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike, kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumes së kompensimit të pacaktuar me këtë Vendim.

6. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Gjakovës, është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
8. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Infrastrukturë
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë
- Arkivit.